

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aksidenti absurd, 20-vjeçari Oskar Kordus humb jetën: një kaproll i futet përmes xhamit të përparmë të makinës
ADRESA	https://lapsi.al/oskar-kordus-humb-jeten-ne-moshen-20-vjecare-nje-kaproll-i-futet-permes-xhamit-te-perparme-te-makines-kishte-luajtur-te-shtunen-i1094332
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:59:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 19:49:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	91b64f6a9fa1f5426b08fd0ca00dd70a5105c75fe7f91e0ddc7738fe10abf1ea
TEKSTI	08fc21656383f55ea3b9f75e9a1bdf7decdd2b3eea50852e44a623bbb6a8756c
PAMJA	70a82821e43dda1c2dc34531bfa399507bfa77e0a9204f95182f20da5dcd80ee

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4b30fb270d7338fcdebed3f5e2bed13af632d206977dd98a6fc425bb6e7292a1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/4b30fb270d7338fcdebed3f5e2bed13af632d206977dd98a6fc425bb6e7292a1

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aksidenti absurd, 20-vjeçari Oskar Kordus humb jetën: një kaproll i futet përmes xhamit të përparmë të makinës

Futbolli polak po vajton këto orë Oskar Kordus, futbollistin 20-vjeçar që të hënën humbi jetën në rrethana sa të pafata, aq edhe absurde.

LAPSİ.AL • 23 SEPTEMBER 2026



Futbolli polak po vajton këto orë Oskar Kordus, futbollistin 20-vjeçar që të hënën humbi jetën në rrethana sa të pafata, aq edhe absurde. Mbrojtësi i ri po drejtonte qetësisht BMW-në e tij në unazën e Gostyn, një rrugë jashtëurbane me nga një korsi për çdo drejtim, kur një Volkswagen i drejtuar nga një burrë 52-vjeçar, që po lëvizte në drejtim të kundërt, goditi një kaproll që po kalonte rrugën. Përplasja e hodhi kafshën si një predhë në korsinë e kundërt, duke goditur drejtpërdrejt makinën e Kordus. Kaprolli theu xhamin e përparmë të BMW-së dhe goditi në fytyrë djalosin. Automjeti i futbollistit më pas doli nga rruga.

BMW-ja e Oskar Kordus, pothuajse e shkatërruar jashtë rruge pasi u godit nga një kaproll

Ndihma e shpejtë, e cila mbërritën në vendngjarje, e gjeti Kordus pa shenja jetësore dhe nisën reanimimin kardiopulmonar, duke arritur të rikthenin funksionet jetësore. Por për Oskar Kordin gjithsesi nuk pati asgjë për të bërë: ai u transportua me helikopter në një spital të Poznanit, por vdiq mbrëmjen e po asaj të hënë nga plagët e marra. Ndërsa shoferi i Volkswagenit pati fat dhe mbeti i padëmtuar. Prokuroria lokale ka hapur një hetim mbi ngjarjen, por duket vërtet se bëhej fjalë për një aksident sa tragjik, aq edhe të pashmangshëm, pa përgjegjësi nga ana e asnjërit prej tyre.



ide



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati

MOTITIRANA

14°C

KËMBIMIEURO

91.46

aktuale

28:33

Protestuesit kërkojnë "kokën" e Ramës: Krejt ekipi në pranga, s'të shpëton dot as banda

08:28



Afro katër muaj në shesh, qytetarët nuk tërhiqen: Kërkojnë largimin e Ramës



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku





Kordus kishte luajtur si titullar vetëm të shtunën e kaluar me fanellën e Kania Gostyn, klubit të tij aktual në IV ligë, që është niveli i pestë i futbollit polak. Ishte ndeshja e tij e shtatë e luajtur këtë sezon, pasi ishte transferuar gjatë verës nga Korona Piaski, ku kishte luajtur për dy vite, gjithmonë në të njëjtën kategori, dhe ku ishte formuar në ekipet e moshave. I lindur më 25 mars 2006, Oskar ishte një mbrojtës qendër që ndoshta në vazhdim të karrierës së tij nuk do të arrijte në skenat më të ndritshme të futbollit evropian, por në skuadrat ku kishte luajtur të gjithë e dinin se mund të mbështeteshin tek një futbollist i besueshëm dhe një shok skuadre i gatshëm të sakrifikohej për tjetrin.



Si Kania Gostyn, ashtu edhe Korona Piaski kanë publikuar mesazhe ngushëllimi në rrjetet sociale për Kordus: “Me trishtim dhe mosbesim të jashtëzakonshëm mësuam për lajmin e ndarjes nga jeta të lojtarit tonë, Oskar Kordus. Në emër të gjithë komunitetit të Kania Gostyn, i shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta familjes, të afërmeve dhe miqve të Oskarit. E ndajmë dhimbjen tuaj në këtë moment jashtëzakonisht të vështirë dhe mendimet dhe zemra jonë janë me ju. Pusho në paqe, Oskar”, shkroi klubi i tij i fundit.



Video që tregon se Rama e dinte paraprakisht për Vlora Hysenin



Përgjimet ekskluzive/ “O shpirt”, “o zemër”. Vlora, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit



Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni



Arrestohet në Morinë shefja e SHISH, Vlora Hyseni



Të këshilluara



Klopp i ndalon lojtarëve të Gjermanisë parukierin: rregulla strikte për kombëtaren e tij

Jürgen Klopp nuk dëshiron të lërë pas dore asnjë detaj me kombëtaren gjermane dhe ka vendosur rregulla të rrepta që të gjithë lojtarët e grumbulluar duhet t'i respektojnë, për të minimizuar shpërqendrimet



Përplasje verbale mes Van Dijk dhe një gazetari në sallën e konferencës: "Keni përhapur marrëzira"

Kapiteni Virgil Van Dijk u përfshi në një debat me Noa Vahle dhe më pas me Maarten Wijffels, Martijn Krabbendam dhe Valentijn Driessen gjatë konferencës për shtyp në prag të ndeshjes.



"Jam futbollisti më i bukur në botë": moda, aludimet dhe raporti i Maduka Okoye me Belen



Sulmi kuqezi kundër teknikut Sylvinho, Daku e Seferi kunja brazilianit: "Tani e ndjejmë rëndësinë"

Në konferencën për shtyp, dy sulmuesit kuqezi Daku e Seferi, kanë shënjestruar brazilianin Sylvinho mes rreshtave, duke i thurur elozhe teknikut të ri Rolando Maran.



Kush është Younes Ebnoutalib, i thirrur nga Klopp te Gjermania me një përvojë te Perugia në Serie C: "Më trajtuan si qen"

Younes Ebnoutalib është një prej emrave të rinj që kanë hyrë në radarët e Gjermanisë. Sulmuesi i Eintracht Frankfurt ka tërhequr vëmendjen me golat e tij



Serie A, parashikimet e Superkompjuterit: Interi kampion, Milan dhe Napoli jashtë Champions

Në pritje për të përjetuar sérish emocionet e Serie A, provojmë të imajinojmë kampionatin që do të jetë falë Superkompjuterit.



E bujshme te Napoli: "Allegri drejt dorëheqjes!". Ja si qendron situata



Belen Rodriguez, natë feste në Milano me portierin e Udineses: lajmi bëhet viral

Me rastin e festimeve për ditëlindjen e saj të 42-të, të organizuara në lokalit argjentinas "El Porteño Prohibido", mes të ftuarve të showgirl-it nga Amerika e Jugut u shfaq edhe Maduka Okoye, portieri i Udineses.



Çështja e arbitrimin, Tebas sulmon Real Madrid: "Jeton në galaktikë tjetër". Replika e Blancos: "Fjalë të padenja"

Ka shpërthyer polemika në Spanjë mes Real Madrid dhe presidentit të La Ligës spanjolle, Javier Tebas, pas ankesave të Los Blancos për arbitrimin në derbin e humbur ndaj Atlético Madrid gjatë fundjavës.



Balliu rrezikon të mos jetë kundër Bjellorusisë: u dëmtua me Rayo Vallecano, po monitorohet nga mjekët

Problemet nuk kanë të mbaruar për Rolando Maran, në vigjilje të debutimit në Nations League. Pasi humbi Pajazitin e Laçin, tekniku italian mund të mos ketë në dispozicion edhe Ivan Balliun

Me sytë katër



21:28

PAMJET/ Rrëzohet gjatë stërvitjes në Uells avioni ushtarak britanik



"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..."/ Aktivistja i zë pritë deputetes së PS

21:17



PAMJET/ 6-vjeçarja kineze vë rekord botëror për zgjidhjen e Kubit të Rubikut

21:27



Dy pilote te Forcave Ajrore Mbreterore Britanike (RAF) u nxoren nga avioni i tyre i stërvitjes përpara se ai të rrëzohe...

PAMJET/ Nis papritur bora në bjeshkët e Deçanit


20:52

Dy VIDEO-t/ Si e paralajmëroi Gaz Bardhi lidhjen Gys Agasi-Vlora Hyseni

16:12

SPORT

→ Të tjerë artikuj



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.